



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 732 Akti

Nr.645 Vendimi
Tiranë, më 11.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 6.4.2023, ora 10:00, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ornela Xhembulla**, ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ornela Xhembulla ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, detyrë në të cilën është emëruar në datën 13.1.2015¹. Këtë detyrë subjekti e ka ushtruar deri në nxjerrjen e urdhrit nr. ***, datë 1.2.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku është emëruar oficerë e policisë gjyqësore. Znj. Ornela Xhembulla, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 165² të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve

¹ Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 13.1.2015, “Për emërimin në detyrën e ndihmëses ligjore”.

² Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë: “1. Këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bën pjesë në subjekte të rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Ornela Xhembulla do t’i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Valbona Sanxhaktari dhe Alma Faskaj, relatores.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).

4. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), i ngritur me short, me vendimin e datës 21.6.2021, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

5. Në datën 7.7.2021 subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e tij.

6. Në përgjigje të *email*-it të dërguar, në datën 21.7.2021 subjekti i është përgjigjur pyetësorit standard, duke parashtruar gjithashtu se ajo nuk është më në detyrën e ndihmëses ligjore, por në detyrën e oficerës së policisë gjyqësore.

7. Znj. Ornela Xhembulla, në datën 10.3.2023, me anë të postës elektronike është njoftuar nga Komisioni lidhur me procesin e rivlerësimit dhe në kuadër të një procesi të rregullt e në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar Komisioni e ka ftuar që të shprehë vullnetin e saj në seancën dëgjimore, fokusi i së cilës do të ishte përfundimi i procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

8. Znj. Ornela Xhembulla, në datën 17.3.2023, ka paraqitur parashtrimet e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit.

9. Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 18.11.2022, vendosi kalimin e çështjes në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 17.13.2023, informoi Komisionin se nuk do të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

II. HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

10. Znj. Ornela Xhembulla ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, detyrë në të cilën është emëruar në datën 13.1.2015³ dhe për shkak të ligjit nr. 84/2016, ky subjekt, në momentin e hyrjes në fuqi të tij, duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

11. Subjekti ka plotësuar dhe dërguar deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 në ILDKPKI; deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

12. Në komunikimin elektronik me Komisionin në datën 21.7.2021, subjekti informoi se: “...me urdhrin nr. ***, datë 1.2.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, jam emëruar oficer e policisë gjyqësore, detyrë të cilën e ushtroj edhe aktualisht”.

³ Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 13.1.2015, “Për emërimin në detyrën e ndihmëses ligjore”.

13. Në vijim të hetimit, Prokuroria e Përgjithshme/Drejtoria e Koordinimit Institucional⁴ informon se me urdhrin e sipërpërmendur të Prokurorit të Përgjithshëm, znj. Ornela Xhembulla është emëruar oficer e policisë gjyqësore në Sektorin e Studimeve, Kërkimeve, Analizës dhe Integritimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, me këtë shkresë, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se: *“Në kushtet kur marrëdhënia e saj e punës si ndihmëse ligjore ka përfunduar, vlerësojmë se kjo punonjëse nuk është më subjekt i ligjit nr. 84/2016”*.

14. Trupi gjykues, me qëllim krijimin e një panorame të saktë të fakteve lidhur me statusin aktual të subjektit të rivlerësimit dhe statusit të saj në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, iu ridrejtua Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesë për informacion⁵ mbi arsyen e përfundimit të marrëdhënies së punës së znj. Ornela Xhembulla si ndihmëse ligjore dhe emërimin në detyrën e re, si dhe mbi faktin nëse ajo ka dhënë dorëheqjen ose jo nga detyra e ndihmësës ligjore.

15. Prokuroria Përgjithshme informoi⁶ se znj. Ornela Xhembulla është emëruar me urdhrin nr. ***, datë 13.1.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, në detyrën e ndihmësës ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe me urdhrin nr. ***, datë 1.2.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, është emëruar oficer e policisë gjyqësore. Në lidhje me faktin nëse ka dhënë dorëheqjen, sqaroi se Sektori i Burimeve Njerëzore nuk disponon një kërkesë me shkrim për dorëheqje nga funksioni i ndihmësës ligjore, por ka sqaruar se: *“...emërimi në pozicionin e oficeres ka qenë me pëlqimin e saj...”*. Gjithashtu, Prokuroria informoi se subjekti ka dhënë dorëheqjen nga detyra e oficeres së policisë gjyqësore dhe pas dorëheqjes Komisioni i Policisë Gjyqësore doli me vendimin nr. ***, datë 30.7.2021, për lirim të saj nga detyra. Aktualisht ajo ushtron funksionin si inspektore pranë institucionit të Avokaturës së Shtetit.

16. Komisioni çmoi t’i ridrejtohet subjektit të rivlerësimit⁷, duke i kërkuar të japë shpjegime lidhur me faktin nëse ka aplikuar (ka depozituar një kërkesë formale) për pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore, nëse emërimi i saj i është nënshtruar një procesi konkurrimi dhe a ka dhënë ajo pëlqimin për të kaluar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore.

17. Në përgjigje, subjekti shpjegoi se⁸: *“Nuk kam marrë pjesë në një proces konkurrimi. Siç parashtrova, emërimi në pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore nuk është bërë bazuar në një kërkesë formale timen dhe as nuk kam marrë pjesë në një proces konkurrimi, por është disponuar me urdhr të Prokurorit të Përgjithshëm. Sa më sipër, nuk ka një akt vullneti formal për dhënie pëlqimi nga ana ime. Së fundi, ju bëj me dije se me urdhrin nr. ***, datë 13.1.2023, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, jam liruar nga detyra e Avokatit të Shtetit në nivel qendror, me dorëheqje. Me vendimin nr. ***, datë 13.1.2023, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, jam emëruar oficer e policisë gjyqësore në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tropojë”*.

18. Trupi gjykues administroi gjetjen e dërguar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit⁹. Në këtë opinion Komisioni informohet se nëpërmjet komunikimit elektronik të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit me Prokurorinë e Përgjithshme, kjo e fundit shpjegon se për kalimin e subjektit në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore nuk ka pasur një proces konkurrimi, por vetëm një urdhr të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilin subjekti kishte mundësi ta ankimonte vetëm në gjykatë.

19. Në vijim, Komisioni iu ridrejtua subjektit nëse e ka ankimuar këtë vendim, e cila, në përgjigje shpjegon se: *“...nuk e kam ankimuar...”*.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.7.2021).

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 3.9.2021.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 8.9.2021).

⁷ Komunikimi elektronik datë 21.2.2023.

⁸ Komunikimi elektronik datë 24.2.2023.

⁹ Gjetja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për subjektin Ornela Xhembulla, nr. *** prot., datë 1.3.2023.

III. ANALIZA LIGJORE MBI ARSYET E NDËRPRERJES SË PROCESIT

20. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi referuar rrethanave të çështjes dhe dokumentacionit të administruara u konstatua se:

- Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor në njësinë ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të pikës 4 të nenit 179/b bën pjesë në rrethin e subjekteve *ex officio*.

21. Marrëdhënia e punës si ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme ka përfunduar me emërimin e saj në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore.

22. Sa më sipër, trupi gjykues çmon të vlerësojë vijimin e procesit të rivlerësimit të subjektit, duke analizuar në rastin konkret ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga Komisioni kryesisht, pa kërkesën e subjektit.

22.1 Neni G i Aneksit të Kushtetutës përcakton që në rastin kur subjekti jep dorëheqjen nga detyra, procesi i rivlerësimit ndërpritet dhe ndaj subjektit aplikohen penalitetet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

22.2 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka disponuar: “*Dorëheqja nga detyra sipas sanksionimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është në vetvete heqje dorë nga procesi, nga kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar në përputhje me ligjin nr. 84/2016*”¹⁰.

22.3 Kolegji, në vendimin nr. 5/2021¹¹ (JR), për subjektin E.Q, ka theksuar se: “*Zbatimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për të gjithë subjektet e rivlerësimit, të cilët me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procesit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në funksion të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*”.

22.4 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka orientuar Komisionin¹² që për zgjidhjen e çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: i) Presidenti i Republikës; ii) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (deri në konstituimin e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor); dhe iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (deri në konstituimin e tij, Prokurori i Përgjithshëm). Si sanksionim kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë..., për një periudhë 15-vjeçare, çka është në kompetencën e tij. Në pikën 94 të këtij vendimi, Kolegji vlerëson shprehjen e vullnetit të pavesuar si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, ndërsa në pikën 56 të tij ka përcaktuar se: “*Verifikimi i vullnetit të subjektit të rivlerësimit për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit kalimtar është kompetencë, por edhe detyrim kushtetues i Komisionit...*”.

22.5 Në vendimin nr. 21, datë 17.6.2022 (JR), për subjektin S.Z, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka disponuar se: “*...pavarësisht vullnetit të brendshëm për t’u larguar nga pozicioni i ndihmësit ligjor..., në kuptimin formal dhe ligjor kjo shprehje vullneti ka krijuar pasoja ligjore vetëm me kërkesën e drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë... për ndërprerjen e kësaj marrëdhënieje pune. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, e cila, në kuptim të procesit të rivlerësimit do të konsiderohet dhe kualifikohet*

¹⁰ Pika 94, vendimi nr. 1/2018 (JR), subjekti i rivlerësimit A.LL.

¹¹ Pika 45.

¹² Pika 97, vendimi nr. 1/2018 (JR), subjekti i rivlerësimit A.LL.

ligjërishit si dorëheqje nga detyra, për shkak se është mbështetur në vullnetin e shprehur të vetë subjektit të rivlerësimit...”.

23. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se në analizë të fakteve dhe provave, kuadrit ligjor dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, rezulton se:

23.1 Kalimi nga detyra e ndihmësit ligjor në atë të oficerit të policisë gjyqësore është një kalim në një detyrë më të rëndësishme dhe në bazë të nenit 10/a të ligjit nr. 8677, datë 2.11.2000, kjo procedurë bëhet nëpërmjet konkurrimit.

23.2 Po ashtu, subjekti nuk ka shprehur për asnjë moment mosdakordësinë e saj për këtë pozicion të ri. Në vijim, subjekti ka ndryshuar përsëri vendin e punës, përkatësisht nga oficer i policisë gjyqësore në atë të inspektorit në Avokaturën e Shtetit dhe më pas është rikthyer në pozicionin e oficerit të policisë gjyqësore, me urdhrin nr. ***, datë 1.2.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm.

23.3 Trupi gjykues çmon se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit vjen në përputhje me vullnetin e saj për të mos qëndruar në pozicionin e këshilltarit ligjor, por për të kryer detyra të tjera të ndryshme dhe më të rëndësishme, do të interpretohet si një vullnet i shprehur i saj për të mos vijuar procesin e rivlerësimit kalimtar.

23.4 Po ashtu, trupi gjykues çmon se në rastin konkret nuk ndodhet para zbatimit të nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, situatë e cila do të çonte në përfundimin e këtij procedimi pa një vendim përfundimtar, sipas nenit 103 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “1. Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. 2. Deklarimi i përfundimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë gjithnjë i arsyetuar dhe kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë”. Kjo për arsye se nuk ndodhet para zbatimit të nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: “2. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”, pasi marrëdhënia e punës si ndihmëse ligjore nuk ka përfunduar për shkaqe ligjore, por me shprehjen në heshtje të vullnetit të saj.

24. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga detyra e këshilltarit ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në këtë nen do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në

nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ornela Xhembulla.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Ornela Xhembulla si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 11.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka